



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.190/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Laziq dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Instituti Demokratik i Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prishtinë për shkak të manipulimit me votues në tubim publik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.06.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.190/2017 e datës 09.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 09.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga nga Instituti Demokratik i Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017 në televizionin Koha Vizion-KTV është raportuar një reportazh nga tubimi i Koalicionit PDK-AAK-NISMA, të mbajtur në Prishtinë ku pjesëmarrësve iu ka kërkuar të nënshkruajn në një listë “Po, unë zotohem se do ta mbështesë Fillimin e ri për Kosovën dhe do të votoj për PDKme nr. 12”.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se kjo mënyrë e grumbullimit të të dhënave të votuesve mund të keqpërdoret në ditën e zgjedhjeve, që nëse nuk dalin të njëjtit në votim të iu bëhet presion përmes telefonit, duke i detyruar për të votuar.

Sipas pretendimeve në ankesë egziston dyshimi se këto përbëjnë elemente të veprës penale, të sanksionuara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 213 Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve.

Kërkojnë nga PZAP-i që brenda kompetencave të saj, nëse vendosë që ka elemente të veprës penale ta përcjellë në Prokurorinë e Shtetit për hetime të mëtejshme sipas nenit 38,46 dhe 120.5 të LZP-së.

Lidhur me ankesën parashtruesi, si provë ka bashkangjitur një CD nga vendi i ngjarjes.

Në përgjigjen në ankesë të datës 10.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA, konsideron se ankesa e KDI-së është krejtësisht e pabazuar dhe në kundërshtim me LZP-në neni 31/38,

rregullë zgjedhore 01/2013, neni 17, pika 1 dhe me Kushtetutën e Kosovës neni 44, pika 1 dhe 2. Poashtu shtojnë se në video në cilën shihet u dedikohet vetëm anëtarëve dhe vullnetarëve të PDK-së dhe jo votuesve në përgjithësi, ky formular është në pajtim me Kushtetutën dhe LZP-në kreu i V-të (Kodi i Mirësjelljes) dhe i njëjti është për përdorim të brendshëm të partisë dhe me rregullat në fuqi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se shkelja e pretenduar dhe e emërtuar si manipulim i referohet situatës hipotetike në të ardhmen se gjëja personat e nënshkruar në listën gjatë kohës së tubimit do të përcillen nga komisionerët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me rastin e votimit në ditën e zgjedhjeve, për të ju bërë presion që të njëjtit ta votojnë koalicionin në fjalë, për më tepër parashtruesi i ankesës me asnjë provë nuk e vërteton faktin se nënshkruerit e listës ditën e tubimit kanë qenë të obliguar për të nënshkruar një list të tillë e po ashtu kjo nuk vërehet as nga videoja e dorëzuar si provë, që gjendet në shkresat e lëndës.

Veprimi i shkelësit të supozuar nuk parashihet si veprim i ndaluar në bazë të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre Kandidatë, për derisa e njëjta përdoret për nevoja të brendshme të subjektit në fjalë. Ndërsa lidhur me pretendimet e parashtruara në ankesë për elemente të veprës penale lëndën do të dërgohet në Prokurorinë Shtetërore për procedim të mëtejshëm në kuptim të nenin 3 pika 11 e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Andaj duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.190/2017 më datën 10.06.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së, në afat prej 24 orëve, nga dita e pranimit në Gjykatën Supreme.